



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:284811
Datë: 22.03.2024
Numri i dokumentit: 05500434

C.nr. 482/2022

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Blerim Istrefi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F. M nga M, të cilin sipas autorizimi me shkrim e përfaqëson V.M avokat në M, kundër të paditurës Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” me adrese:”Ukshin Kovaçica” pn.40.000 Mitrovicë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson I.O, me objekt të kontestit anulim i vendimit nga marrëdhënia e punës dhe kompensim i të ardhurave personale qe rrjedhin nga puna, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor publik me datën 08.03.2024, me dt. 22.03.2024 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET** në tersi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit F.M nga M me të cilën ka kërkuar që të **ANULOHET**- si i kundërligjshëm vendimi i datës 09.11.2021 i nxjerr nga Këshilli i Fakultetit të Edukimit dhe Njoftimi i datës 30.11.2021, me numër 2327.. mbi anulimin e konkursit i nxjerr nga e paditura Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” si dhe ti t’i bëhet kompensimi i borxhit ne emër te pagave që do t’i takonin si bashkëpunëtor i jashtëm për periudhën 01.10.2021–30.09.2022 në emër te pagës neto shuma prej 2,394€, ne emër te kontributit pensional shuma 140.00€, si dhe ne emër te tatimit në burim 266.00€ apo ne shumën e përgjithshme 2.800€ me kamat ligjore prej 8% nga data 17.12.2021 si date e paraqitjes se padisë e deri ne pagesën te gjitha këto ne afate prej 7 nga dita e marrjes se aktgjykimit e deri ne pagesën definitive nen kërcënimin e përmbartimit te dhunshëm
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta të bëra në këtë procedurë kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi ka parashtruar padi kundër të paditurës me datë 17.12.2021, me objekt të kontestit anulimin i vendimeve që kishin të bënin me punësimin e tij si bashkëpunëtorë i jashtëm, po ashtu kompensim i të ardhurave si fitim i munguar.

Në padi ka shtuar se me datën 01.10.2021 me nr. te protokollit 1712, e paditura ka shpallur konkurs për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime në bazë të nevojave të njësive akademike brenda Universitetit për vitin akademik 2021/2022 në cilësinë e bashkëpunëtorit të jashtëm për lëndët: Edukim Shëndetësor dhe Vështirësitë në të nxënë. Me datë 09.11.2021 Këshilli i Fakultetit të Edukimit ka nxjerre vendim-propozim me të cilin ka shqyrtuar dhe aprovuar raportin e komisionit rezencues nr :444, të datës 09.11.2021, i emëruar nga i njëjti Këshill sipas konkursit të shpallur nr. të prot.1712 te datës 01.10.2021 për angazhim mësimdhënësit për lëndët e sipër cekura me kandidatin e suksesshëm B.Sh, Ku paditësi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankese me propozimin që të hedhet poshtë Vendimi i Këshillit të Fakultetit të Edukimit, mirëpo e paditura e ka shpallur njoftimin me e cilin ka njoftuar se e ka anuluar konkursin për pozitën te cilën kam aplikuar duke mos u lëshuar në arsyetimet e të njëjtit.

Përgjatë shqyrtimit gjyqësorë dhe në fjalën përfundimtare paditësi ka mbetur ne tërësi pranë kërkesëpadisë si dhe precizimit të të njëjtës dhe ka kërkuar që të anulohen si të kundërligjshme vendimi i datës 09.11.2021 i nxjerr nga Këshilli i Fakultetit të Edukimit dhe Njoftimi i datës 30.11.2021, me numër 2327 ..mbi përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm të nxjerr nga e paditura Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” si dhe për periudhën 01.10.2021 – 30.09.2022 në emër të pagave qe do ti fitonte paditësi në pozitën kontestuese në lartësi neto 2,394€, kontributi pensional 140.00€, tatimi në burim 266.00€, apo shumën e përgjithshme prej 2.800€ dhe i ka propozuar gjykatës që nga provat e administruara pretendimit e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe se pala e paditur ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme në raport me paditësin dhe ka bërë shkelje të rregullave dhe procedurave ligjore, ashtu që të njëjtit i ka shkaktuar dëm material, andaj gjykatës i ka propozuar që të bie vendim më të cilën e aprovon kërkesëpadinë e palës paditëse si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e padisë shumën prej 104 euro, në emër të përfaqësimit për katër seanca shumen prej 540 euro(nga 135 euro për secilën seanca), si dhe 200 euro ne emër te pagesës për ekspertize financiare.

E paditura me përgjigje ne padi, përgjatë shqyrtimit gjyqësorë dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi të datës 07.12.2023, duke kundërshtuar në tersi kërkesëpadinë e paditësit si te pa bazuar me arsyetimin se me datë 01.10.2021 Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” ka shpallur konkurs për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime në bazë të nevojave të njësive akademike për vitin 2021/2022, i njëjti konkurs është hartuar ne pajtim me dispozitat e Ligjit nr .04/L-037 për Arsim te Larte, Statutit të Universitetit dhe Rregullores nr.1670 te datës 28.09.2021 për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm ne Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”, ku në mbledhjen e Këshillit të Fakultetit të Edukimit të datës 09.11.2021 është nxjerr propozimi vendimi me nr të protokollit 469/2 të datës 09.11.2021, ku është shpallur kandidati i suksesshëm B.Sh. Më tutje ka shtuar se konsiderojnë se në rastin konkret nuk ka objekt shqyrtimi sepse konkursi ka qenë vetëm për një periudhe kohore të caktuar dhe është e pamundshme që të bëhet rikthimi në gjendjen e mëparshme, gjithashtu komisioni nuk e ka mohuar faktin që kandidati F.M i plotëson kriteret e konkursit, por duke u bazuar në rregullore është në diskrecion të komisionit dhënia e përparësisë kandidatit të caktuar me kriteret më të përafërta me pozitën. Sa i përket anulimit të konkursit, e paditura e njofton gjykatën se pasi që janë evidentuar shkelje të afateve dhe procedurave që burojnë nga rregulloret për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm ka bërë anulimin e konkursit duke u bazuar në dispozitat e Ligjit të Procedurës së përgjithshme Administrative dhe konform statutit të të paditurës. Sa i përket pretendimit të paditësit për kompensimin lidhur me kohen sa i njëjti

nuk e ka ushtruar funksionin, e paditura në përgjigje në padi ka theksuar se nuk ka asnjë obligim për paditësin pasi që të njëjtit nuk kanë krijuar asnjë marrëdhënie kontraktuale që ti detyroj për një gjë të tillë. Andaj i ka propozuar gjykatës që ta refuzojnë ë tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit F.M nga M.

Gjykata me qellim që të vërtetohet në mënyrë të saktë gjendja faktike, sipas propozimit të paditësit ka caktuar ekspertizë financiare për llogaritjen e shumave mujore të cilat paditësi ka pasur mundësi ti realizoj si ushtrues i pozitës së bashkëpunëtorit të jashtëm ashtu siç pretendon paditësi për periudhën kohore nga data 01.10.2021 – 30.09.2022.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, në shqyrtimin kryesor-publik, gjykata bëri administrimin e provave dhe atë: Njoftimi me nr te protok me nr.2327/ i datës 30.11.2021, Vendimi-propozimi me nr të protok.469/2 i datës 09.11.2021, Raporti i komisionit vlerësues i datës 09.11.2021, Konkursi me nr te protok.1712 i datës 01.10.2021, Publikimi i punimit për paditësin, Shkresa e kërkuar ne faqen About Scout për kandidatin e propozuar për pozitën që kërkohet të anulohet, Aktvendimi i Gjykatës Themelore Prishtinë-Departamenti Çështje Administrative me A.nr.3004/21 i datës 03.02.2022, Ekspertiza financiare e punuar nga eksperti financiar M.F e datës 19.02.2024, Shkresa e të paditurës me nr te protokollit 30 të dt.14.02.2024 së bashke me shkresat tjera të konkursit(Shkresa e datës 29.09.2021, Vendimi i të njëjtës datë, Propozimi për shpalljen e konkursit, Pasqyra për angazhimin akademik për vitin 2021-2022, Orari i ligjëratave për të njëjtën periudhë dhe Programi për vitin 1.2.3.4)

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është në tersi si e pabazuar.

Gjykata konstaton se paditësi konform dispozitave ligjore nga nenet 78 dhe 79 të Ligjit të Punës i ka plotësuar kushtet ligjore për të iniciuar kontest pune në gjykatë. Padia është brenda afatit ligjor të përcaktuar me Ligjin e Punës.

Faktet jo Kontestuese:

Mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se e paditura Universiteti “Isa Boletini” me datën 01.10.2021 me nr. te protokollit 1712 ka shpallur konkurs për vitin 2021/2022 për bashkëpunëtorë të jashtëm si mësimdhënës për lëndët Edukim Shëndetësorë dhe Vështirësi ne te nxënë.

Me raportin mbi vlerësimin e kandidateve që i plotësojnë kushtet të lëshuar nga e paditura me datën 08.11.2021, vërtetohet fakti se paditësi F.M dhe kandidati i përzgjedhur B.Sh i kanë plotësuar kriteret e përcaktuar ne piken 2 te nenit 7 te Rregullores për procedurat e vlerësimit sa i përket angazhimit te bashkëpunëtorëve te jashtëm ne UIBM, me nrProt.1670 te datës 28.09.2021.

Me Vendimin me nr te protokollit 469/2 të dt. 09.11.2021 Këshilli o Fakultetit të Edukimit si kandidat të suksesshëm ka përzgjedhur B.SH e po ashtu i ka propozuar senatit të UIBM-së miratimin e propozimit.

Universiteti i Mitrovicës ka anuluar konkursin për pozitën tani kontestuese, ky fakt vërtetohet nga njoftimi i dt. 30.11.2021, e po ashtu nuk ishte kontestues ky fakt në mes palëve ndërgjyqëse.

Nga ekspertiza financiare e punuar nga eksperti M.F konstatohet se paditësit si ligjërues për vitin akademike 2021/2022 apo për periudhën kohore 01.10.2021–30.09.2022 për lëndët Edukimi Shëndetësor dhe Vështërsi të nxënë parashihet se do ti realizonte të ardhurat si në vijim: Në emër të borxhit të pagave neto për periudhën kohore shumen prej 2.394 euro, ne emër të TKP 5% shumen prej 140.00 euro, ne emër të tatimit në burim sipas shkallëve tatimore shumën prej 266.00 euro, apo në total për të gjitha kategoritë shumën e përgjithshme të detyrimit prej 2.800 euro, te cilës ekspertizë gjykata ja fali besimin e plot pasi që e njëjta është e punuar në mënyrë profesionale dhe brenda vëllimit të përcaktuar nga gjykata.

Kontestues në këtë çështje në mes palëve ndërgjyqëse ishte fakti se vendimi e të paditurës për përzgjedhjen e kandidatit e suksesshëm për bashkëpunëtorë të jashtëm a ka qenë i drejt si dhe njoftimi për anulimin e konkursit a është i kundërligjshëm përkatësisht a ka qenë i bazuar në dispozita ligjore të Ligjit për Procedurë të Përgjithshme Administrative dhe në Udhëzime administrative të të paditurës, si dhe paditësit a i takon kompensimi i kërkuar me padi si pasoje e vendimit të datës 09.11.2021 dhe njoftimit të datës 30.11.2021 për anulimi e konkursit.

Baza juridike dhe vlerësimet e gjykatës:

Sipas ligji nr. 04/1-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, në nenin 13 par.2 pika 2.3 përcaktohet se “Bartësit e licencuar të arsimit të lartë gëzojnë të drejtat nga dispozitat e këtij ligji për të, zgjedhur mësimdhënësit dhe personelin tjetër, për të përcaktuar kushte lidhur me pranimin e studentëve, metodat e mësimdhënies dhe vlerësimin e studentëve, të miratuara nga AKA-ja”.

Statuti i Universitetit “Isa Boletini”, përkatësisht neni 13 pika 1.1 dhe 1.2 përcaktojnë se “Të drejtat dhe detyrat e Universiteti janë të zgjedhë autoritetet qeverisëse dhe menaxhuese dhe të përcaktojë mandatin e tyre; të rregullojë strukturat dhe aktivitetet e tij, përmes rregullave të Universitetit, bazuar në dispozitat e këtij Statuti, në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe me akte të tjera nënligjore të nxjerra prej tij dhe në përputhje me ligjet e tjera në fuqi.

Ndërsa në nenin 14 par 1 pika 7 përcaktohet se “Universiteti është person juridik dhe ka subjektivitet të plotë ligjor, lidhur me të gjitha të drejtat dhe detyrat, në lidhje me çështjet që trajtohen në ligjet e aplikueshme, duke përfshirë: emërimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës së personelit akademik dhe jo akademik, si dhe ushtrimin e të gjitha detyrave të një punëdhënësi, siç është paraparë me legjislacionin në fuqi”, ndërsa sipas nenit 7 para 5 pika 5.2 të Rregullores për Procedurën e vlerësimit përcaktohet se nëse një kandidat nuk i plotëson kriteret nga par. 2 të këtij neni “kandidatët do të angazhohen duke aplikuar përparësinë si në vijim; në rastin e kushteve të barabarta përparësi ka kandidati me përvojë më të gjatë të punës, pastaj kandidati i gjinisë femërore kurse në rastet tjera mbetet në diskrecionin e komisionit vlerësues dhënia e përparësisë së kandidatit të caktuar.”

Andaj në bazë të rregullores dhe vlerësimit të kandidatit komisioni nuk e ka mohuar faktin se paditësi ka plotësuar kriteret mirëpo i njëjti komision duke u bazuar në rregullore i ka përzgjedhur kandidatin tjetër me kriteret që i janë përgjigj kushteve të konkursit për pozitën e shpallur nga ana e të paditurës.

Me njoftimin e dt. 30.11.2021 e paditura e ka anuluar konkursi për pozitën bashkëpunëtor i jashtëm për lëndët e lartcekura për shkak të shkeljeve të afateve të përcaktuara me rregulloren 1670 të datës 28.09.2021, ku paditësi pretendon se konkursi i anuluar është i kundërligjshëm sepse e paditura është dashur të vendos për ankesën e paditësit të cilin e ka parashtruar kundër

vendimit të datës 09.11.2021 e jo ta anulohet konkursin në fjalë, mirëpo sipas Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative përkatësisht sipas të nenit 53 par. 1 përcaktohet se “Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj”, ndërsa me nenin 54 i këtij Ligji, mund të anulohet apo të shfuqizohet, me qëllimin për të vendosur ligjshmërinë. Tutje ne nenin 55 par 1 përcaktohet se “Një akt administrativ i paligjshëm për arsye të tjera nga ato ta parapara nga neni 54 i këtij Ligji, mund të anulohet apo të shfuqizohet, me qëllimin për të vendosur ligjshmërinë”. Kurse nenin 58 par. 1 përcaktohet se “Anulimi në rastin e paraparë nga neni 55 i këtij Ligji si dhe shfuqizimi në rastin e paraparë nga paragrafi 1 i nenit 57 të këtij Ligji, mund të bëhet në çdo kohë”.

Meqenëse e paditura ka konstatuar se ka pasur shkelje të afateve dhe procedurave që burojnë nga rregullorja për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe me qëllim që ti evitoje ato shkelje ka anuluar pjesërisht konkursin e datës 01.10.2021 për disa pozita, andaj në bazë të njoftimit të datës 30.11.2021 vërtetohet fakti se nuk është anuluar konkursi sa i përket pozitës për bashkëpunëtorë të jashtëm në fakultetin e edukimit por edhe konkurset në fakultete tjera të cilat pozita janë shpallur me të njëjtin konkurs, andaj me rastin e anulimit të konkursit sa i përket pozitës së kontestuar, padia e paditësit veç se tani është pa objekt shqyrtimi sa i përket vendimit-propozimit të dt. 09.11.2021, kurse sa i përket njoftimit të dt. 30.11.2021 është nën kompetencë të të paditurës për konkurset e shpelluara nga ana e sajë që ti anulohet kur konstaton se ka shkelje të procedurave, andaj dhe mbi këto rrethana e duke u bazuar në dispozitat e lartcekura gjykata e refuzoj kërkesëpadinë e paditësit sa i përket anulimit të vendimeve dhe atë të datës 09.11.2021 i nxjerr nga Këshilli i Fakultetit të Edukimit dhe Njoftimi i datës 30.11.2021, me numër 232711 mbi anulimin e konkursit.

Po ashtu sa i përket kërkesës së paditësit për kompensimin e pagave për periudhën kohore 01.10.2021–30.09.2022, të njëjtin kërkesë e refuzoj si të pa bazuar pasi që gjykata vendosi si në diapozitivin e aktgjykimit duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditësit lidhur me anulimin e vendimeve për për zgjedhjen e kandidatit të suksesshëm dhe atë të anulimit të konkursit pasi që të mund të kompensohen pagat e papaguara fillimisht duhet të ekzistoj një kontratë pune ose të kryhet puna e caktuar, ku Kontrata e punës duhet të jetë në harmoni të plotë me dispozitat e Ligjit të Punës përkatësisht dispozitat nga neni 11 i po të njëjtit ligj ku parashihet përmbajtja e kontratës së punës. Ndërsa pika 1.11 e cila thotë citoi kontrata e punës duhet të përmbajë edhe “lartësinë e pagës bazë, si dhe ndonjë shtesë ose të ardhur tjera”, e në rastin konkret neni 2 i kontratës së lidhur në mesë palëve kanë përcaktuar pagën bazë për punën të cilën e kryen.

Është rregull e përgjithshme edhe parimi i së drejtës, se palët me vullnetin e tyre të lirë e të shprehur mund të krijohet raporti juridik gjegjësisht marrëdhënia juridike, si dhe po ashtu me këtë vullnet mund të ndryshojnë marrëdhëniet juridike, pasi që kontrata është ligj për palët (Pacta Sund Servanda), andaj duke u mbështetur në këtë parim palët kontraktuese marrin për obligim që ti përmbushin obligimet e tyre kontraktuese ashtu siç figurojnë në kontratë, apo ta ndryshojnë atë me ndonjë kontratë të mëvonshme.

Palët kontraktuese kanë për obligim që duke u bazuar në ndershmërinë dhe ndërgjegjshmërinë t’i përmbushin obligimet kontraktuale, ndaj njëra tjetrës.

Neni 15 I LMD-së përcakton se “Kontrata është e lidhur kur palët kontraktuese janë marrë vesh për elementet thelbësore të kontratës” ndërsa në rastin konkret asnjëherë nuk është lidhur kontrate në mes palëve ndërgjygjëse madje paditësi asnjëherë nuk është zgjedhur nga ana e të paditurës në pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm dhe si mungesës të një kontrate ose një vendimi me anë të së cilit paditësi do të kishte themeluar marrëdhënie pune me të paditurën

përkatësisht do të ishte zgjedhur në pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm, andaj të njëjtit nuk i takon kompensimi i pagave për periudhën 01.10.2021 e deri me 30.09.2022 në total shumën prej 2.800 euro.

Gjykata shqyrtoi dhe analizoi edhe provat e tjera të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, por gjeti se të njëjtat ishin pa ndikim në vendosjen ndryshe në këtë çështje kontestuese.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi si në pikën e dytë të dispozitivit, ashtu që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës, konform nenit 450 të LPK-së, ngase autorizuari i palës së paditur nuk i ka kërkuar shpenzimet procedurale, kurse kërkesëpadia e paditësit është e refuzuar si e pabazuar.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm, Divizion Civil
C.nr.482/22, datë 22.03.2024

GJYQTARI
Blerim Istrefi

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtën e ankesës brenda afatit 7 ditor, që nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.